



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit

SP-096

Prishtinë, më 11 dhe 18 prill 2017

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 11 DHE 18 PRILL 2017**

Seancën e drejtuan nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti.

Nënkryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi, Valdete Bajrami, Njomza Emini, Abdyl Ymeri, Jasmina Zhivković, Bislim Zogaj, Albulena Haxhiu, Shpejtim Bulliqi dhe Emilija Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Sali Salihu i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me kyçjen e komunës së Vitisë në autostradën “Arbër Xhaferri” nëpërmjet fshatit Gërlicë. Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, në lidhje me kontrollin e cilësisë së derivateve që importohen.
Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me iniciimin e përgjegjësisë për dëmtimin e buxhetit të vendit mbi 35 milionë €, për shkak të dy rasteve që ka marrë vendime Tribunali Ndërkombëtar i Arbitrazhit.
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me kohën kur ka filluar me punë Komisioni qeveritar për demarkacionin e kufirit shtetëror të Kosovës me Malin e Zi.
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë, Dhurata Hoxha, në lidhje me funksionimin e gjykatave dhe prokurorisë në pjesën veriore të Mitrovicës.
Ministrja Dhurata Hoxha nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Salih Salihu i parashtroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në lidhje me funksionimin e ndërmarrjes regjionale për grumbullimin e mbeturinave “Ecohigjiena” në Gjiilan.
Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me ndërtimin e një rrethrotullimi në hyrje të qytetit të Ferizajt.
Ministri Lutfi Zharku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me pagesat e skemave sociale nëpërmjet Postës së Kosovës.
Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Armend Zemaj i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me njohjen e përvojës së punës të fituar gjatë periudhës 1989-1999 për të punësuarit në Kosovë.
Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Armend Zemaj i parashtroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Memli Krasniqi, në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes që Kosova ka arritur me Komisionin Evropian në fushën e zhvillimit rural në Kosovë.
Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, në lidhje me largimin e deponisë së mbeturinave në afërsi të fshatrave Gurrëz dhe Komogllavë të komunës së Ferizajt.

Ministri Ferat Shala nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, në lidhje me masat që ka ndërmarrë ministria dhe Qeveria për mbrojtjen e qytetarëve nga fatkeqësitë natyrore sipas dispozitave ligjore.

Ministri Ferat Shala nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me mungesën e transportit publik në ANP “Adem Jashari” Prishtinë.

Ministri Lutfi Zharku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me qëndrimin e Qeverisë në raport me marrëveshjen për demarkacionin e kufirit shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Salih Morina i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Avdullah Hoti, në lidhje me veprimet e ministrisë për plotësimin e kriterëve që parashihen me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Ministri Avdullah Hoti iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Salih Morina i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Avdullah Hoti, në lidhje me vështirësitë që kanë komunat e Kosovës për shpenzimin e buxhetit.

Ministri Avdullah Hoti iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë, Dhurata Hoxha, në lidhje me moslejimin e vizitave shëndetësore për të burgosurin, z. Sylejman Selimi.

Ministrja Dhurata Hoxha nuk ishte e pranishme në sallë.

Kryesuesja e seancës dha pauzë njëorëshe për drekë.

Pas pauzës, kryesuesja deklaroi se për mungesë kuorumi seanca nuk mund t'i vazhdojë punimet. Ajo i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 14:55 minuta.

* * *

E martë, më 18 prill 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 11 prill

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Kryesuesi procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 9, 14, 15, 27 shkurt dhe 2, 9 e 10 mars 2017.

4. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në seancat e kaluara për votimin e kësaj pike nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Ai e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, kjo pikë shtyhet për seancën e radhës.

5. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në seancat e mbajtura më 9 shkurt, 31 mars dhe 11 prill 2017 kjo pikë është proceduar për votim, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Ai e hodhi në votim Propozim-rezolutën në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, kjo pikë shtyhet për seancën e radhës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimi për këtë projektligj ka përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 10 mars 2017. Në seancën plenare të mbajtur më 31 mars 2017 është proceduar për votim amendamenti numër 1 i këtij projektligji, por nuk është miratuar.

Procedimi i mëtutjeshëm për votimin e amendamenteve të tjera të këtij projektligji në mungesë të kuorumit është shtyrë.

Ai i procedoi për votim amendamentet prej 2 deri në 15, të propozuar nga Komisioni Funksional.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

7. Shqyrtimi i Propozim-Programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Programi i Punës i Kuvendit për vitin 2017 është hartuar në bazë të Programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017, planeve të punës së komisioneve parlamentare, Programit kombëtar për zbatimin e MSA-s dhe agjendës evropiane për reforma evropiane për vitin 2017.

Ai hapi diskutimin lidhur me Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2017.

Lidhur me Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2017 diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV-së, Bali Muharremi, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputetët Melihate Tërmkolli, Faton Topalli, Teuta Haxhiu dhe Sala Berisha-Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 57,
Kundër----- 14,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2017.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës

Në mungesë të propozuesit për ta paraqitur dhe arsyetuar këtë projektligj, Kuvendi e shtyu shqyrtimin e tij për seancën e radhës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandojnë miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Agim Ademaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL, e paraqiti dhe e arsyeto raportin me rekomandime.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-132 për automjete

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Në këtë projektligj nga Komisioni FunkSIONAL janë propozuar 87 amendamente.

Ai, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, i hodhi në votim amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, të gjithë përmjherë, të cilat i miratoi Kuvendi.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 68,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin nr. 05/L-132 për automjete.

9. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Integritime Evropiane e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021, në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi ministria për Integritime Evropiane, znj. Mimoza Ahmetaj.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021.

Lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021 diskutuan: deputetja Valdete Bajrami, në emër të Komisionit FunkSIONAL, Fatmir Xhelili, në emër të GP të PDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, Puhije Demaku, në emër të GP të LVV-së, Bali Muharremi, në emër të GP të AAK-së, Valdete Bajrami, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputetët Vjosa Osmani, Fatmir Xhelili dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 60,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.
(votimi është përsëritur)

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021.

10. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me Propozim-vendimin nr. 20/2017, dt. 10 mars 2017, të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit i ka rekomanduar për mosmiratim.

Kryetarja e Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Lirije Kajtazi, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin për mosmiratimin e Propozim-vendimit të Avokatit të Popullit.

Lidhur me rekomandimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione për Propozim-vendimin nr. 20/2017, dt. 10 mars 2017, të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit diskutuan: Salihe Mustafa, në emër të GP të PDK-së, Lirije Kajtazi, në emër të GP të LDK-së, Mytaher Haskuka, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, Nenad Rashiq, në emër të GP të LS-së, Shukrije Bytyqi, në emër të GP “Nisma” dhe Qerim Bajrami, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët Emilija Rexhepi dhe Hajdar Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit Funkcional.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 44,
Kundër ----- 11,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Propozim-vendimi nr. 20/2017, datë 10 mars 2017, i Institucionit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit i kthehet Institucionit të Avokatit të Popullit.
2. Propozimi për kandidatë për zëvendës të Avokatit të Popullit të bëhet në përputhje me nenin 10, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe me nenin 8, paragrafi 3, të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij.

11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigorisë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigorisë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Haxhi Shala, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të këtij komisioni.

Lidhur me raportin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigorisë diskutuan: Agim Çeku, në emër të GP të PDK-së, Milazim Haliti, në emër të GP të LDK-së, Aida Dërguti, në emër të GP të LVV-së, Rustem Berisha, në emër të GP të AAK-së, Haxhi Shala, në emër të GP “Nisma” dhe Duda Balje, në emër të GP “6+”, si dhe deputeti Nuredin Ibishi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me zbatimin e Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigorisë.

12. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë

Shqyrtimi i raportit të lartshënuar u shty për seancën e radhës.

13. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media nga dy kandidatët e propozuar.

Ai shtoi se Kuvendi duhet ta zgjedhë një anëtar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë me votim të fshehtë nga kandidatët e propozuar: Driton Qeriqi dhe Vlorë Berisha.

Kryetari i Komisionit ad hoc, zoti Hajdar Beqaj, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin e këtij komisioni.

Kuvendi, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, e formoi Komisionin votues për administrimin e procedurës së votimit në këtë përbërje: Hajdar Beqaj nga GP i PDK-së, Veton Berisha nga GP i LDK-së, Rustem Berisha nga GP i AKK-së, Sërgjan Popoviq nga GP i LS-së dhe Kujtim Paqaku nga GP “6+”.

Pastaj, kryesuesi i ftoi një nga një deputetët që të votojnë për kandidatët e propozuar nga ana e Komisionit ad hoc.

Pas përfundimit të procedurave të votimit, numërimit të votave, raportin e Komisionit votues e paraqiti deputeti Hajdar Beqaj. Ai deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 65 deputetë, të pavlefshme janë 8 fletëvotime.

Kandidati Driton Qeriqi i ka fituar 32 vota,
Vlora Berisha i ka fituar 25 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, asnjëri nga kandidatët e propozuar Driton Qeriqi dhe Vlorë Berisha nuk i morën votat e mjaftueshme për t’u zgjedhur anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 13:12 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit:

Xhavit Haliti

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale

(Procesverbali nuk është miratuar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit)